



## SUCCESS STORY

### Qasja në regjistrat e gjendjes civile në Kosovë kurrë nuk ka qenë më e lehtë

Dokumentet e gjendjes civile tani janë të qasshme 24/7



[Photo by Advancing Kosovo Together]

Shërbimi i kioskut elektronik u mundëson qytetarëve që me lehtësi të marrin certifikata të gjendjes civile pa prituri në radhë para zyrave komunale të gjendjes civile.

*“Marrja e certifikatave nga regjistrat e gjendjes civile tani është bërë shumë më e lehtë për shkak se më nuk jemi të detyruar të presim në radhë dhe nevojitet vetëm një minutë për të marrë dokumentin e duhur,” shpjegon Shaban Beka, qytetar i Vushtrrisë.*

Prill 2017— Viteve të fundit, disa qeveri lokale në Kosovë kanë përmirësuar shërbimet për qytetarët e tyre si pjesë e përpjekjeve për arritje të një qeverisjeje komunale më efikase. Megjithatë, përkundër përmirësimit të shërbimeve të gjendjes civile, komunat e Vushtrrisë, Pejës dhe Shtërpcës ballafaqoheshin me vështirësi si pasojë e rritjes së kërkesave për certifikata të gjendjes civile, si ato të lindjes, gjendjes martesore dhe vendbanimit.

Shumë pjestarëve të komuniteteve pakicë, si dhe të kthyerve që ishin zhvendosur gjatë konfliktit të viteve 1998-1999 të cilët po riintegroheshin në këto komuna, u nevojitet dokumentacioni për të gëzuar shërbime sociale dhe pensione si dhe, që është edhe më me rëndësi, për të kërkuar të drejtat pronësore.

USAID-i, përmes programit të tij Avancojmë Kosovën së Bashku, ka nënshkruar marrëveshje partneriteti me komunat për implementimin e planeve të tyre për ndërtim të kapaciteteve dhe për t’u ndihmuar, përfundimisht, që të rrisin efikasitetin e qeverisjes. Këto marrëveshje përfshinë edhe instalimin e numrit total prej pesë e-kiosqeve nga marsi deri në qershor të vitit 2016. E-kiosqet inovative u mundësuan qytetarëve që në mënyrë efikase t’i marrin dokumentet e nevojshme 24 orë në ditë, 7 ditë në javë.

“Sipas mendimit tim, marrja e certifikatave nga regjistrat e gjendjes civile tani është bërë shumë më e lehtë për shkak se më nuk jemi të detyruar të presim në radhë dhe nevojitet vetëm një minutë për të marrë dokumentin e duhur. Udhëzimet janë shumë të qarta dhe shërbimi është i lehtë për t’u përdorur,” shpjegon Shaban Beka, qytetar i Vushtrrisë.

USAID-i gjithashtu siguroi udhëzime për përdorimin e e-kiosqeve për zyrtarët komunal dhe përfaqësuesit e komuniteteve, me qëllim të një informimi sa më të mirë lidhur me këtë shërbim të ri. Brenda më pak se një viti, janë

Prill 2017

U.S. Agency for International Development  
[www.usaid.gov](http://www.usaid.gov)

përpunuar rreth 7.500 kërkesa përmes e-kiosqeve në tri komunat e lartpërmendura.

“Qytetarët tanë mund të marrin dokumente të ndryshme të regjistrimit civil pas orarit të rregullt të punës dhe kjo mundësi do të reduktojë rradhët para zyrës komunale të gjendjes civile duke përmirësuar njëkohësisht cilësinë e shërbimeve që ofron komuna jonë,” thotë Bekim Selmani, shef i Zyrës së Gjendjes Civile në Vushtrri.

Avancojmë Kosovën së Bashku i USAID-it, i cili vepron nga prilli i vitit 2014 deri në prill të vitit 2017, ka për qëllim të rrisë bashkëpunimin dhe ndërveprimin konstruktiv ndëretnik në mes popullatave shumicë dhe atyre pakicë në Kosovë, gjë e cila ka rëndësi thelbësore për sigurinë dhe stabilitetin e rajonit.

Mbi 14.000 njerëz kanë qenë pjesëmarrës në aktivitete për adresimin e nevojave sociale, papunësisë dhe përmirësimit të shërbimeve komunale në 16 komuna. Rreth 24.000 njerëz kanë patur përfitime nga gati 50 projekte të realizuara.